



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 244, Datë 02.12.2021

MBI

**PROPOZIMIN E OST SH.A., PËR TREGUESIT E KRITEREVE STANDARDE TË
CILËSISË SË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
VITIN 2022**

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, 16, 19, gërma “h” dhe “j”, nenit 20, gërma “a” dhe nenit 90, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM-së) nr. 584, datë 08.10.2021, “Për Shpalljen e Gjendjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike”, Kodit të Rrjetit të Transmetimit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, i ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 129, datë 04.06.2018; neneve 2, 5 dhe 6, të “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike” miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 207, datë 18.12.2017, Rregullores së Procedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve Ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.04.2018; Treguesve të Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Transmetimit për vitin 2021, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 255, datë 21.12.2020; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, pasi shqyrtoi relacionin nr. 145/5 prot., datë 26.11.2021, të Drejtorisë së Monitorimit të Tregut dhe Inspektiveve dhe Drejtorisë së Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standardeve, “Mbi propozimin e OST sh.a., për Treguesit e Kriterëve Standarde të Cilësisë së Shërbimit të Transmetimit të Energjisë Elektrike për vitin 2022”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 207, datë 18.12.2017, ka miratuar “Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, e cila parashikon detyrimin e shërbimit publik të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) që të përmbushë standardet e cilësisë së furnizimit të specifikuara nga Kodi i Rrjetit të Transmetimit dhe nga kjo Rregullore.
- Me shkresën nr. 6417/1 prot., datë 04.11.2021, protokolluar në ERE me nr. 1030/1 prot., datë 05.11.2021, OST sh.a., paraqiti informacionin e sa kërkuar nga ERE, lidhur me zbatimin e treguesve të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit për tre mujorin e tretë të vitit 2021, si dhe propozimin sa i përket rishikimit të standardeve për vitin 2022.

- Nga verifikimet e kryera, vërehet se treguesit e cilësisë së OST sh.a., gjatë 3 mujorit të tretë të vitit 2021 janë përmirësuar ndjeshëm, krahasuar me 3 mujorin e parë dhe të dytë. Disa treguesi: Koha Mesatare e Ndërprerjes së Furnizimit me Energji Elektrike (AIT), Energjia e pa Furnizuar (ENS), si dhe Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve (SAIDI), duken të përmirësuar brenda parametrave të përcaktuara në Treguesit e Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Transmetimit për vitin 2021, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 255, datë 21.12.2020. Trendi shihet si përmirësim apo ulje e disa parametrave që i përafrohen sa më shumë Treguesve të vitit 2021, sipërcituar, ndonëse mungon ende 3 mujori i fundit i vitit 2021.
- Treguesit e Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Transmetimit, të paraqitur nga OST sh.a., janë të përcaktuar dhe në akte të tjera të miratuara nga bordi i ERE-s, respektivisht: parametrat teknikë të cilët lidhen me tensionin dhe frekuencën janë të përcaktuar në *“Kodin e Rrjetit të Transmetimit”*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, i ndryshuar me vendimin e bordit të ERE nr. 129, datë 04.06.2018, si dhe në *“Rregulloren e Procedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve Ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit”*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 87, datë 20.04.2018.
- Treguesit e Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Transmetimit, të paraqitur nga OST sh.a., janë si vijon:
 - **Cilësia e Frekuencës (FQ):** OST sh.a., këtë tregues e ka paraqitur brenda diapazonit ± 200 mHz. Kjo vlerë brenda diapazonit ± 200 mHz, është konform kërkesave të *“Kodit të Rrjetit të Transmetimit”*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, i ndryshuar.
 - **Koha e Nevojshme për tu Përgjigjur Kërkesave për Lidhje të Reja:** OST sh.a. këtë tregues e ka paraqitur sipas përcaktimeve në pikën 2.2.3, të *“Rregullores së Procedurave për Lidhjet e Reja dhe Modifikimin e Lidhjeve Ekzistuese me Rrjetin e Transmetimit”*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 87, datë 20.04.2018, brenda afatit 60 ditore.
 - **Cilësia e Tensionit (VQ):** OST sh.a., këtë tregues e ka paraqitur sipas përcaktimeve në nenin 38, të *“Kodit të Transmetimit”*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, i ndryshuar.
 - **Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve (SAIDI):** OST sh.a., ka propozuar ndryshim të SAIDI, që i referohet kohëzgjatjes mesatare të ndërprerjeve për klientët, të cilët kanë ndërprerje gjatë një periudhe kohore (tremujore, gjashtëmujore, vjetore). Ky tregues është propozuar të bëhet 100 minuta, ndërsa për vitin 2021, është 104 minuta. Propozimi i këtij treguesi të cilësisë së shërbimit rezulton më i ulët, pra është përmirësuar në krahasim me vitin 2021.
 - Përveç sa më sipër, në analizë të informacionit të paraqitur nga OST sh.a., mbi propozimin e rishikimit për Treguesit e Kritereve Standarde të Cilësisë së Shërbimit të Transmetimit të Energjisë Elektrike për vitin 2022, evidentohet se nga 8 Tregues të Matjes për Cilësinë e Furnizimit të cilët duhet të llogariten nga OST sh.a., dhe të raportohen në ERE sipas përcaktimeve të Rregullores për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancën e Sigurisë së

Rrjetit në Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike, 7 Tregues të propozuar nga ana e shoqërisë gjenden të njëjtë me Treguesit e miratuar nga bordi i ERE-s me vendimin nr. 255, datë 21.12.2020, për vitin 2021.

- Me VKM-në nr. 584, datë 08.10.2021, “Për Shpalljen e Gjendjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike”, u vendos shpallja e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, efektet e së cilës shtrihen deri më 15 prill 2022.
- Në pikën 4, të nenit 90, të ligjit nr.43/2015, i ndryshuar, është parashikuar se: “Të licencuarit nuk janë përgjegjës për sanksionet e ardhura si rezultat i ndërprerjes ose kufizimit të energjisë elektrike, për rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, përveç rasteve kur situata e emergjencës vjen si rezultat direkt i fajit të të licencuarit”.
- Për sa më lart, duke qenë se propozimi i OST sh.a., për treguesit e cilësisë synohet të hyjë në fuqi më datë 01.01.2022, duke marrë shkas nga gjendja e emergjencës aktuale të furnizimit të energjisë elektrike, efektet financiare/aplikimi i sanksioneve për Treguesit e Matjes për Cilësinë e Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Transmetimit për vitin 2022, do të trajtohet sipas përcaktimeve në pikën 4, të nenit 90, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e Treguesve të Kriteve Standarde të Cilësisë së Shërbimit të Transmetimit të Energjisë Elektrike për vitin 2022, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. OST sh.a., të raportojë në ERE çdo 3 (tre) muaj mbi ecurinë e zbatimit të Treguesve të Matjes së Cilësisë së Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Transmetimit për vitin 2022.
3. Drejtoria e Mbrojtjes së Konsumatorit, Performancës dhe Standarteve të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrir AHMETI

TABELA E STANDARDEVE TË CILËSISË PËR VITIN 2022, OST SH.A.

Parametrat e Cilësisë Furnizimit	Propozimi për vitin 2022
a) Koha Mesatare e Ndërprerjes së Furnizimit me Energji Elektrike (AIT)	35 min
b) Energjia e pa Furnizuar (ENS)	467 MWh
c) Cilësia e frekuencës (FQ)	Brenda diapazonit +/- 200mHz
d) Periudha e Njoftimit të Ndërprerjeve të Planifikuara në Sistemin e Transmetimit	72 orë
e) Koha e Nevojshme për t’ju Përgjigjur Kërkesave për Lidhje të Reja	Brenda 60 ditëve
f) Indeksi i Kohëzgjatjes Mesatare të Ndërprerjeve (SAIDI)	100 min
g) Cilësia e Tensionit (VQ)	Brenda diapazonit: -10%, +11.8.
h) Përqindja e Ankesave për Cilësinë e Tensionit	0%